

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Prishtinë, datë, 11.02.2021

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, duke marrë parasysh nenin 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, bazuar në shtojcën 16 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 07/2020, Ligjin Nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, Planin e Punës së MZHR-së për vitin 2021 si dhe bazuar në nenin 12 të Rregullores 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit të OJQ-vë, nxjerrë;

V E N D I M

Për shpalljen e Thirrjes Publike për mbështetje financiare publike për projekte/ programe të organizatave jo-qeveritare në fushën e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar.

I

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF-Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i MZHR-së, kodi i organizatës buxhetore 221 në kuadër të kategorisë ekonomike Subvencione dhe Transfere - kodi ekonomik 21200.

II

1. Mjetet e përmendura në nenin I do të shpërndahen në bazë Thirrjes Publike për Financimin e Projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshinë:
 1. Teksti i thirrjes publike
 2. Udhëzimet për aplikantët
 3. Formularët e aplikimit
 4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
 5. Format për raportimin e zbatimit të projektit
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
 2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
 3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta

4. Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme)
 5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike.
3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
 2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
 3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

IV.

1. Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të MZHR-së: <https://mzhr.rks-gov.net/language/sq/>.

V.


1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, MZHR do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VI.

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, Udhëheqësi i institucionit do të nxjerr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
2. MZHR do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Departamenti për Zhvillim Rajonal.

VII.

1. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit.

Besim Kamberaj

Zv. Sekretar i Përgjithshëm

Vendimi i'u dërgohet;

- Ministrit të MZHR-së;
- Udhëheqësit të DZHR-së dhe
- Arkivit të MZHR-së.